

Ne perputhje me Nenin 28, paragrafi i 3-te i Ligjit 97/2007, Per Qendren Kombetare te Regjistrimit, ky dokument perben:

**AKT THEMELIMI
DHE
STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“ARK Management” SH.P.K.**

Sot me date 26 Gusht 2024, palet e meposhtme:

Z.Arlind Dema, atesia Kujtim amesia Diana, lindur me 27/04/1986 ne Tirane e banues ne Tirane mbajtes i leternjoftimit nr. BR3409846 me nr.personal I60427081S, dhe

Z.Boiken Gashi, atesia Agim amesia Albana, lindur me 16/03/1996 ne Tirane e banues ne Tirane, mbajtes i leternjoftimit nr. BC0417522 me nr.personal J60316053C,

vendosen te nenshkruajne kete Akt Themelimi dhe Statut per krijimin e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar, aktiviteti i se ciles rregullohet nga legjislacioni shqiptar ne fuqi.

**KAPITULLI I
FORMA, EMERTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHEZGJATJA**

Neni 1 – Forma

- 1.1. Shoqeria “**ARK Management**” Sh.p.k. (ne vijim “Shoqeria”) krijohet ne formen e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar, dhe veprimtaria e saj rregullohet me ane te ketij Statuti dhe Aktit te Themelimit.
- 1.2. Shoqeria vepron sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi.
- 1.3. Akti i Themelimit dhe Statuti jane ne perputhje me legjislacionin shqiptar qe ka karakter te detyrueshem, ndersa çeshtjet qe nuk jane shprehimisht te parashikuara ne to, plotesohen nga legjislacioni shqiptar.

Neni 2 – Emertimi

- 2.1 Emertimi i Shoqerise eshte “**ARK Management**” Sh.p.k..

Neni 3 – Objekti i shoqerise

3.1 Objekti i aktivitetit te Shoqerise eshte: Projektim, mbajtje, implementim, administrim dhe konsulence te sistemeve dhe te softwareve, te bazes se dhenave, te telekomunikacionit, transmetimit te bazave te te dhenave dhe inerkonektivitetit ne teresi; perfaqesimin dhe ndermjetesimin ne trasaksione tregtare dhe ne ate te sherbimit ne favor te kompanive apo firmave te tjera qe operojne ne fusha te implementimit te softveve te ndryshem ne vecanti dhe ne fusha te ndryshme ne pergjithesi; montim dhe riparim pajisjesh elektronike dhe informatike; projektimi dhe implementimi i sistemeve elektronike dhe telekomunikacionit si dhe software-ve perkatese; ndjekje dhe kontroll i realizimit te projekteve; konsulence teknike, ekonomike e juridike per specifikime teknike te rretave dhe sistemeve te shkembimit te informacionit, ruajtjes se tij si dhe per gara dhe kontraktme; importim dhe instalim. Te bleje apo te zoteroje ne ndonje menyre tjeter, te importoje , magazinoje, ruaje, eksportoje apo tregtoje me shumice dhe pakice mallra ndryshme, perfshire ato ushqimore, bujqesore e blegtorale, industrial, lende te pare minerare, si dhe te do lloj malli tjeter. Te ushtroje veprimtari te Duty Free Shop, ne perputhje me dispozitat ne fuqi. Shoqeria ka giithashtu te drejte te kete pjesemarrje ne shoqeri te tjera shiptare si dhe te ndermarre do akt financiar, ekonomik apo tregtar te lidhur me objektin kryesor te saj dhe /ose qe gjykohet I nevojshem apo I leverdishem per te. Te paketoje mallra dhe lende te importuara. Te prodhoje, riparoje, importoje, bleje, shese, eksportoje,

lere me gera dhe ne pergjithesi te tregtoje ose te merret me do lloj pajisjesh , artikujsh, aparaturash, makineri per fabrika, vegla, mallra, sende te do lloji te cilat mund te perdoren ose me te cilat mund te merret shoqeria me ndonje nga objektet e saj. Te zoteroje, administroje, te bleje te shese, te kembeje dhe ne pergjithesi te tregtoje dhe/ose te ndermjetesojë ne tregtimin e çdo lloj pasurie te luajtshme ose te paluajtshme ose dhe ne lidhje me te drejtash mbi keto pasuri. Te kryeje konsulence, keshillime financiare apo menaxhimi ne lidhje me do lloj pasurie te paluajtshme. Te kryeje çdo biznes, pune apo veprimtari qe lidhet me do pasuriqe te luajtshme apo te paluajtshme ne pergjithesi.

Te kryeje vete ose se bashku me te tjere operacione konsulence, keshillime financiare revizionimi, menaxhimi dhe/ose kerkimi. Te ndertoje, menaxhoje konstruktoje , ndryshoje, zmadhoje, riparoje, adaptoje, magazine, zyra etj. Te sherbeje si perfaqesues shitje dhe marketingu, agent shitjeje per firma vendase dhe te huaja etj. Te angazhohet ne shitje me shumice dhe pakice dhe te hape dyqane, dege dhe/ose zyra po te jete e nevojshme per arritjen e gellimeve te shogerise etj.

Projektim, zbatim i veprave, ndertim dhe rikonstruksioni siperfaqesh ndryshme private apo shteterore. Ne fushen e ndertimit te objekteve civile (si banesa individuale, kolektive, objekte industriale, bujqesore, ura etj). Ne fushen e investimeve, duke vepruar si investitor direkt ose ndermjetes i firmave te huaja per prodhimin e materialeve te ndryshme, ne fushen e turizmit, financave, kambizmit, bankave. Kryerjen e aktiviteteve te ndryshme tregtare me konsigacion, aktivitete ekonomike me material porosites ne fusha te ndryshme.

Prodhim dhe transmetim te materialeve filmike dhe televizive video/audio. Tregti te produkteve te ndryshme. Konsulence marketingu. Import eksport i produkteve te kancelarise. Realizim i reklamave te ndryshme. Tregti me shumice dhe pakice te produkteve te kancelarise. Tregti me shumice dhe pakice te produkteve te pastrimit, bojrave per printera, produkteve elektronike. Tregti me shumice dhe pakice te lodrave per femije. Sherbim dhe konsulence per mirmbajtjen e rrjeteve kompjuterike dhe te internetit. Sherbime dhe tregti te produkteve te vezhgimit, sinjaleve dhe kamerave te vezhgimit. Tregti me shumice dhe pakice te materialeve te buta dhe veshjeve speciale. Riparime, sherbime dhe shitje me pakice pajisje elektrike, elektronike, informatike, Tregtimi, import eksport me shumice dhe pakice te materialeve te pajisjeve elektrike, pajisjeve industriale e elektroshtepiake, pajisjeve e sistemeve/impianteve te ftohjes e ngrohjes (kondicionimit) si dhe impianteve te tjera te cfaredo lloji. Projektim dhe instalim i impianteve e pajisjeve elektrike, elektroshtepiake, industrial, sistemeve te ftohjes e ngrohjes (kondicionimit) si dhe impianteve te tjera te cfaredo lloji ne vendet e ushtrimit te aktivitetit dhe jashte tyre ne objekte te ndryshme. Sherbime mirembajtje dhe servisi te ndryshem per materiale e pajisje elektrike, pajisje industrial e elektroshtepiake si dhe per pajisje dhe sisteme te ftohjes e ngrohjes (kondicionimit) si dhe per impiante te tjera te cfaredo lloji ne vendet e ushtrimit te aktivitetit dhe jashte tyre ne objekte te ndryshme. Sherbime catering, realizime eventesh, promocione te ndryshme . Shoqeria do te kryeje te gjitha aktivitetet e mesiperme, si dhe cdo veprimtari qe do konsiderohet e nevojshme dhe e pershtatshme per arritjen e objektit dhe qe nuk bie ne kundershtrim me ligjin shqiptar ne fuqi.

Neni 4 – Selia

- 4.1. Selia e Shoqerise eshte: Rr Tirane Tirane TIRANE Rruga Don Bosko, pallati nr.12, kati 3, ap.5
- 4.2. Transferimi i selise se Shoqerise ne nje vend tjeter behet me vendimin e Asamblese se Ortakeve.
- 4.3. Asambleja e Ortakeve mund te vendose hapjen e filialeve, degeve dhe perfaqesive te Shoqerise ne qytete te tjera te Shqiperise.

Neni 5 – Kohezgjatja e veprimtarise

- 5.1. Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise do te jete me nje afat te pacaktuar.
- 5.2. Shoqeria mund te priset perpara ketij afati ose mund te ndryshoje kohezgjatjen e saj me vendim te Asamblese se Ortakeve.

KAPITULLI II

KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NDARJA DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE

Neni 6 – Kapitali themeltar

- 6.1. Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100,000 (nje qind mije) Leke.
- 6.2. Kapitali themeltar i shoqerise perbehet nga 2 (dy) kuota te gjitha te nenshkruara dhe te shlyer, me vlere nominale 50,000 Leke (pesedhjete mije Leke).
- 6.3. Ortaket e shoqerise jane **Z.Arlind Dema** dhe **Z.Boiken Gashi**.

Neni 7 – Kontributet

- 7.1 Kontributi ne kapitalin e shoqerise eshte ofruar si me poshte:
 - **Z. Arlind Dema**, ka ofruar nje kontribut ne para te barabarte me 50,000 Leke (pesedhjete mije leke) ne favor te shoqerise ne themelim e siper.
 - **Z. Boiken Gashi**, ka ofruar nje kontribut ne para te barabarte me 50,000 Leke (pesedhjete mije leke) ne favor te shoqerise ne themelim e siper.
 -
- 7.2 Sipas kontributit te mesiperm:
 - **Z. Arlind Dema** zoteron 1 (nje) kuote qe i korrespondon me 50% (pesedhjete) te kapitalit te Shoqerise;
 - **Z. Boiken Gashi** zoteron 1 (nje) kuote qe i korrespondon me 50% (pesedhjete) te kapitalit te Shoqerise;
 -

Neni 8 – Rritja e kapitalit themeltar

- 8.1 Kapitali themeltar mund te rritet pa kufi ne çdo moment, nje ose disa here, me vendim te Asamblese se Ortakeve.
- 8.2 Ne rast rritjeje te kapitalit, te gjithë ortaket kane te drejten te nenshkruajne rritjen ne raport me pjeset e kapitalit te zoteruara. Ne rast se disa nga ortaket nuk e ushtrojne kete te drejte, pjeset e tyre mund te nenshkruhen nga ortaket e tjere proporcionalisht me pjeset e kapitalit te zoteruara prej tyre.

Neni 9 – Zvogelimi i kapitalit themeltar

- 9.1 Shoqeria mund te zvogeloje kapitalin themeltar me vendimin e Asamblese se Ortakeve. Ne çdo rast kapitali themeltar nuk mund te zvogelohet nen kufijte e parashikuar nga ligji.
- 9.2 Zvogelimi i kapitalit perballohet nga secili prej ortakeve ne te njejten mase me pjeset e kapitalit te zoteruara prej tyre.

Neni 10 – Transferimi i kuotave

- 10.1 Kuotat janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.
- 10.2 Në rast transferimi në çdo lloj forme, si me shpërblim ashtu edhe pa shpërblim në kuptimin me të gjere të fjalës, duke përfshirë këtu edhe dhurimin në favor të subjekteve të tjere të ndryshëm nga ortakët, kuotat duhet me parë t'i ofrohen në parablertje ortakëve të tjere.
- 10.3 Në një rast të tillë ortakë që do të transferojë kuotën e tij duhet të njoftojë ortakët e tjere, me leter rekomande me kthim përgjigje, mbi synimin për shitje, duke përcaktuar çmimin, kushtet, modalitetet, emrin e blerësit dhe afatet e transferimit. E drejta e parablertjes duhet t'i referohet të gjitha kuotave të ofruar për shitje.
- 10.4 Ortakët do të kenë në dispozicion 15 (pësembëdhjete) dite nga marrja e letrës rekomande, për t'i komunikuar ortakut që transferon kuotat, synimin e tyre për të ushtruar apo jo të drejtën e parablertjes. Në rast se ata nuk përgjigjen në afatin e caktuar, prezumohet se kanë hequr dorë nga e drejta e tyre e parablertjes.
- 10.5 Në rast se oferta pranohet nga disa ortakë, kuotat e ofruara nga ortakë që transferon kuotat, do të ndahen nga ortakët pranues, në të njëjten masë me kuotat që ata zoterojnë, përveç rastit kur ka një marrëveshje të kundërt. Në asnjë rast, pranuesi i ofertes nuk mund të ushtroje pjesërisht të drejtën e parablertjes.
- 10.6 Në rast se nuk ushtrohet e drejta e parablertjes, kuotat mund t'u transferohen të tereve plotësisht apo pjesërisht, me vendimin pozitiv të Asamblesë së Ortakëve.
- 10.7 Në rast të transferimit të kuotave për shkak të trashëgimisë *mortis causa* ortakët e tjere kanë të drejtë të shprehin pelqimin e tyre për ortakët e rinj. Në rast se nuk jepet pelqimi, kuotat mund t'u transferohen të tereve plotësisht apo pjesërisht, me vendimin pozitiv të Asamblesë së Ortakëve.

KAPITULLI III ASAMBLEJA, ADMINISTRATORET DHE EKSPERTI KONTABEL

Neni 11 – Asambleja e ortakëve dhe kompetencat e saj

- 11.1 Organi vendim-marrës i Shoqërisë është Asambleja e Ortakëve.
- 11.2 Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për çështjet vijuese: ndryshimet e statutit, emerimi e shkarkimi i administratorëve, ekspertëve kontabel e likuidatorëve, zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit, transferimi i kuotave, shpërndarja e fitimeve, riorganizimi dhe prishja e shoqërisë, miratimi i bilancit dhe për çdo vendim tjetër parashikuar nga ky Statut apo nga legjislacioni përkatës.

Neni 12 – E drejta e pjesëmarrjes dhe e votes

- 12.1 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në Asamble, të paraqesë mendimin e tij dhe të japë atë votë sa është numri i kuotave që ai zoteron.
- 12.2 Çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër jo-ortak, i pajisur me prokurë me shkrim, me anën e së cilës mund të japë votën e tij.
- 12.3 Ortakë nuk mund të leshojë prokurë për votim për një pjesë të kapitalit që zoteron, në qoftë se voton personalisht për pjesën e mbetur.

Neni 13 – Thirrja e Asamblesë së Ortakut të Vetem/Ortakëve, Kuorumi dhe Vendimet

- 13.1 Asambleja e Ortakëve thirret të pakten një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar për miratimin e bilancit, të raportit të Administratorit, ekspertit kontabel sidhe inventarit.
- 13.2 Asambleja mund të thirret në çdo moment nga një prej Administratorëve sidhe prej një ose disa ortakëve që përfaqësojnë të pakten 5% (pese për qind) të kapitalit themeltar. Asambleja duhet të thirret nëpërmjet njoftimit me leter rekomande me kthim përgjigje që duhet t'u dërgohet ortakëve – në adresën që rezulton në Librin e Ortakëve – dhe ekspertit kontabel (nese është emëruar), të pakten 15 (pësembëdhjete) dite përpara mbledhjes së Asamblesë. Thirrja duhet të përmbajë informacion mbi llojin e Asamblesë, mbi çështjet që do të trajtohen dhe për të cilat do të merret vendim, mbi vendin, orën dhe datën e thirrjes së parë dhe të dytë.
- 13.3 Asambleja mund të thirret edhe jashtë selisë së Shoqërisë, brenda apo jashtë Republikës së

Shqipërisë.

- 13.4 Në rast se Asambleja e Ortave nuk mbledhet me thirrjen e parë për mungesën e kuorumit të parashikuar në pikën 13.7 të këtij Statuti, Asambleja e Ortave do të thirret brenda 30 (tridhjetë) ditësh me të njëjtin rend dite.
- 13.5 Mbledhjet e Asamblese mund të mbahen edhe nëpërmjet telekonferencës dhe videokonferencës, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen dhe t'u lejohet atyre të ndjekin diskutimin dhe të ndërhyjnë në momentin e trajtimit të çështjeve në rend të ditës; pasi të jenë verifikuar këto kërkesa që duhet të rezultojnë në procesverbalin e mbledhjes, Asambleja konsiderohet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari në të cilin duhet të ndodhet edhe Sekretari i mbledhjes.
- 13.6 Asambleja do të thirret dhe mbahet rregullisht edhe pa respektimin e formaliteteve të njoftimit, në rast se janë të pranishëm ortaket që përfaqësojnë të paktën kapitalin themeltar.
- 13.7 Vendimet e Asamblese së Ortave, për të cilat kërkohet një shumicë e thjeshtë, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortaket me të drejtë vote që zoterojnë më shumë se 30% (tridhjetë përqind) të kapitalit themeltar. Vendimet e Asamblese së Ortave që kërkojnë një shumicë të cilesuar, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortaket me të drejtë vote që zoterojnë të paktën 51% (pesëdhjetë e një përqind) të kapitalit themeltar.
- 13.8 Asambleja e Ortave vendos ndryshimet e statutit, zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit, transferimin e kuotave, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, me votën pro të $\frac{3}{4}$ (tre të katërtat) e ortave të pranishëm që zoterojnë të paktën 51% (pesëdhjetë e një përqind) të kapitalit themeltar. Në të gjitha rastet e tjera, Asambleja e Ortave merr vendime me shumicë të thjeshtë votash të ortave që zoterojnë më shumë se 30% (tridhjetë përqind) të kapitalit themeltar.
- 13.9 Çdo Asamble drejtohet nga një ortak ose ndonjë person tjetër i caktuar nga vete Asambleja. Për pasqyrimin e vendimit Asambleja emëron një Sekretar, që mund të jetë edhe jo-ortak.
- 13.10 Vendimet e Asamblese duhet të nënshkruhen nga Kryetari i Asamblese dhe nga Sekretari.

Neni 14 – Administrimi

- 14.1 Shoqëria administrohet nga të paktën 1 (një) Administrator i cili do të qëndrojë në detyrë deri në shkarkim apo dorëheqje ose për një periudhë prej 5 (pese) vitesh. Administratori i parë i Shoqërisë është emëruar **Z. Arlind Dema**, atësia Kujtim atësia Diana, lindur më 27/04/1986 në Tiranë e banues në Tiranë, mbajtes i letërnjoftimit nr. BR3409846 me nr.personal I60427081S.
- 14.2 Përfaqësimi ligjor i Shoqërisë i besohet Administratorit. Administratori mund të ushtroj të gjitha fuqitë konform me sa parashikohet në nenin 95 të Ligjit n. 9901 të datës 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare".
- 14.3 Administratorët mund të emërojnë përfaqësues të posaçëm për veprime apo kategori të caktuara veprimësh.

Neni 15 – Eksperti kontabel i autorizuar

- 15.1 Në rast se kërkohet nga ligji apo vendoset nga Asambleja e Ortakut të Vetem/Ortave, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabel të Shoqërisë mund t'i besohet një ose disa eksperteve kontabel të autorizuar.
- 15.2 Eksperti kontabel i autorizuar mund të shkarkohet sipas mënyrës së parashikuar nga legjislativi në fuqi.

KAPITULLI IV VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPERNDARJA E FITIMEVE

Neni 16 - Viti financiar dhe bilanci vjetor

- 16.1 Viti financiar fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor te secilit vit.
- 16.2 Viti i pare financiar fillon ne daten e regjistrimit te Shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe perfundon me 31 dhjetor te te njejtit vit.
- 16.3 Bilancet vjetore, inventari, raportet e Administratorit dhe ekspertit kontabel te autorizuar miratohen nga Asambleja me shumicen e kerkuar nga Ligjit n. 9901 te dates 14.04.2008 "Per tregtaret dhe Shoqerite tregtare".
- 16.4 Miratimi i dokumentave qe lidhen me vitin financiar duhet te behet brenda 6 (gjashte) muajve qe nga fundi i vitit financiar.

Neni 17 – Fitimet

- 17.1 Fitimet qe rezultojne nga bilanci vjetor, u shperndahen ortakeve ne proporcion me pjeset e kapitalit themeltar te zoteruara.
- 17.2 Asambleja mund te vendose edhe zbritje te veçanta ne favor te rezervave te jashtezakonshme ose per qellime te tjera apo dhe shtyrjen e shperndarjes se fitimeve, plotesisht ose pjeserisht, per vitet financiare te ardhshme.

KAPITULLI V SHPERNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE

Neni 18 – Prishja

- 18.1 Shoqeria priset me perfundimin e afatit te parashikuar nga Statuti, ose perpara perfundimit ne rastet e parashikuara nga ligji, ose me ane te nje vendimi te Asamblese se Ortakut te Vetem/Ortakeve, me shumicen e kerkuar per ndryshimet ne statut.
- 18.2 Shoqeria nuk priset ne rast te humbjes se zotesise per te vepruar, vdekjes, ose falimentimit te ortakeve.

Neni 19 – Likuidimi

- 19.1 Ne rast prishje, Shoqeria duhet te likuidohet.
- 19.2 Per te administruar kete procedure, Asambleja emerone nje ose me shume likuidatore, te cilet paraqesin raportet perfundimtare mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivit te Shoqerise, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohen e nevojshme per te perfunduar likuidimin.
- 19.3 Me perfundimin e procedures se likuidimit, Asambleja do te vendose mbi bilancin financiar perfundimtar, mbi punen e kryer nga likuiduesi dhe mbi perfundimin e procesit te likuidimit.
- 19.4 Pas pagimit te kreditoreve dhe mbledhjes se kredive, likuidatori do t'i shperndaje te ardhurat perfundimtare te likuidimit ortakeve, ne proporcion me pjeset e kapitalit te zoteruara prej tyre ne kapitalin themeltar.

Neni 20 - Zgjidhja e mosmarreshjeve

- 20.1 Te gjitha mosmarreshjet qe mund te lindin ne lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e ketij statuti dhe aktit te themelimit, si edhe ato qe mund te lindin ne pergjithesi midis ortakeve (perveç atyre personale apo jashte Shoqerise) ose midis nje apo me shume ortakeve dhe Shoqerise, do te zgjidhen ne menyre miqesore dhe do te diskutohen ne menyre te drejtperdrejte ndermjet paleve te

interesuara.

20.2 Ne rast se nuk arrihet ne nje zgjidhje miqesore te mosmarreveshjes, ato do t'i besohen Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Neni 21 – Gjuha

21.1 Ky Akt Themelimi dhe Statut eshte hartuar ne 2 (dy) kopje ne gjuhen shqipe.

* * *

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE

“ARK Management” shpk

Arlind DEMA



Boiken GASHI

